



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr.477/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurës F.K , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II.nr. 1906/15 të dt.30.5.2016, për shkak të veprës penale : rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 1 e lidhur me par 6 të KPRK-së , pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurës F. K. dhe të prokurorit të shtetit Lumturije Vuçetaj , dhe të me dt.12.4.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

E pandehura F. K. e lindur me dt. 15.1.1986 në P. Rruga P. Nr. 13/8 ku edhe tani jeton, e njohur, e bija R. dhe nënës N. e gjinisë Z., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTORE

Për arsye se :

Me dt. 29.9.2015, rreth orës 16:10 ,, në rrugën B. L. K P, nga pakujdesia ka shkelur nenin 42 pika 1 të Ligjit mbi sigurinë e komunikacionit rrugor të Kosovës që ka rezultuar me lëndime të lehta trupore për të dëmtuarin L.V. , A. S. dhe dëshira M., në atë mënyrë që ditën kritike e pandehura gjersa ka qenë duke e drejtuar automjetin e saj të llojit F. P , me targa regjistrimi ----- pikërisht në vendin e lartcekur ka bërë kyçje të pasigurt në rrugën kryesore duke mos e respektuar shenjën vertikale të komunikacionit STOP si dhe nuk ka respektuar përparësinë e kalimit , me ç’ rast është ndeshur me veturën e llojit Audi A3 me targa regjistrimi ----- të cilin e drejtonte i dëmtuari L. V., e ku si pasojë dëmtime trupore kanë pësuar të lartcekurit si dhe janë shkaktuar dëme materiale në të dy automjetet.

-me çka ka kryer veprë penale: rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 1 e lidhur me par 6 ë KKPR-së

Prandaj gjykata të pandehurës konform nenit 41, 85, 86 dhe nenit 378 par 1 lidhur me par 6 të KPK-së I SHQIPTON

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilën të pandehurës i behët me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbënë veprë penale për të cilën nëse ajo sërish e përsëritë gjykata do ti shqiptoi sanksion më të rëndë penal.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 15 euro –kurse në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 60 euro 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të dëmtuarit për realizimin eventual të kërkesë pasurore juridike – udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt. 30.5.2016 kundër të pandehurës F. K. ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.1906/15 , për veprë penale : rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 1 e lidhur me par 6 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurën ta shpallë fajtores , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestar e pandehura – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasoja e pranimi përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e ka pranuar fajësinë. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë e pandehura e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe asnjë mënyrë e ka pranuar.

Meqenëse e pandehura e pranoj fajësinë gjyqtari kaloi në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, më parë nuk ka qenë e gjykuar, dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurës do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform neni 450 të KPPRK-së

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform neni 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform neni 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.12.4.2017

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .